



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 maj 2013
Nr. ref.: RK415/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI73/12

Parashtrues

Bujar Sahitaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev.
Nr. 24/2009, të 7 dhjetorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Bujar Sahitaj, me vendbanim në fshatin Sopijë, komuna e Suharekës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 24/2009, i 7 dhjetorit 2011, i cili i është dërguar parashtruesit më 15 shkurt 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës ankohet se pronësia e një pjese të tokës në shtratin e lumit në fshatin Sopijë është transferuar nga pronësia shoqërore në atë private me anë të një vendimi të Gjykatës Komunale në Suharekë. Pretendohet se kjo ka ndikuar negativisht në një pjesë tjetër të tokës që i takon banorëve të tjerë të fshatit, një ndër të cilët është edhe parashtruesi. Prandaj, pretendohet se ka rezultuar me shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe të nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 31 korrik 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Me Vendimin e Kryetarit të Gjykatës, Nr. GJR. 73/12, të 4 shtatorit 2012, gjyqtari Altay Suroy u emërua Gjyqtar raportues. Në po të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit, Nr. KSH. 73/12, u caktua Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 27 shtator 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua edhe Gjykatës Supreme të Kosovës.
8. Më 28 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese i dërgoi një shkresë Gjykatës Komunale në Suharekë, në të cilën kërkohej të dorëzohet në Gjykatë Kushtetuese fletëpranimi që dëshmon datën kur e ka pranuar parashtruesi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 24/2009, e 7 dhjetorit 2011.
9. Më 3 tetor 2012, Gjykata pranoi një shkresë nga Gjykata Komunale e Suharekës, të cilës i ishte bashkëngjitur kopja e fletëpranimit, e nënshkruar më 15 shkurt 2012 nga bashkëshortja e parashtruesit.

10. Më 15 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë.

Përmbledhja e fakteve

11. Me Aktgjykimin C. Nr. 83/89, të 18 majit 1989, Gjykata Komunale e Suharekës ia ndau familjes R. të drejtat pronësore mbi shtratin e lumit në hapësirë prej 0.50.60 ha, në bazë të "parashkrimit fitues". Më herët, kjo pjesë e tokës ishte e dokumentuar në librat kadastralë si shtrat i lumit dhe pronë shoqërore që i takonte Komunës së Suharekës. Regjistrimi i tillë ishte zbuluar të jetë bërë gabimisht, pasi që familja R. e kishte blerë këtë pjesë të tokës 35 vjet më parë dhe që nga atëherë e kishte shfrytëzuar vazhdimisht.
12. Drejtoria për Çështje Juridike Pronësore, me Aktvendimin 10-466/190, të 6 tetorit 2006, vendosi që pjesa specifike e tokës së shtratit të lumit prej 0.11,45 ha, e blerë nga familja R., ka qenë e uzurpuar, pasi aktgjykimi fillestar, që ia njihte të drejtat pronësore, nuk ishte ekzekutuar e as nuk ishte regjistruar në librat kadastralë si pronë private, dhe edhe më tutje e njeh si pronë shoqërore.
13. Pronarët e parcelave kadastrale 351-354, të cilat janë të ngjitura me parcelën 1528, pohonin se prona e kontestuar ishte duke u dëmtuar, pasi pronarët e ngushtonin atë duke ndërtuar një mur. Nëpërmjet kësaj, ata donin të tjetërsonin rrjedhën natyrale të lumit dhe kështu të rrezikoheshin nga vërshimet tokat fqinje dhe të vështirësohej qasja në to.
14. Me parashitresën kundërshtuese, E. Nr. 266/06, Kuvendi Komunal i Suharekës i bëri thirrje Gjykatës Komunale në Suharekë të refuzojë procedurën e përmbarimit, pasi kishte skaduar afati i përgjithshëm 10-vjeçar për përmbarimin e vendimeve gjyqësore.
15. Më 9 korrik 2006, ishte iniciuar procedura e përmbarimit të aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Suharekë, në bazë të kërkesës së kreditorit R. A. R., me qëllim të vërtetimit të së drejtës së tij pronësore.
16. Komuna e Suharekës, më 27 tetor 2007, propozoi pezullimin e kësaj procedure, me arsyetimin se kërkesa për përmbarimin e aktgjykimit është bërë jashtë afatit kohor, deri sa Prokurori Publik i Qarkut në Prizren të vendosë përkritazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës.
17. Kryeshefi Ekzekutiv kishte bërë një ankesë, Nr. 976, më 24 nëntor 2006, e cila ishte refuzuar si e pabazë dhe kështu mbeti në fuqi Vendimi i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike Pronësore, Nr. 466/190.
18. Gjendja e përshkruar nga pronarët e parcelave kadastrale 351-354 ishte konfirmuar nga një inspektim i vendit nga një ekspert i gjeodezisë së Gjykatës Komunale, në seancën e 8 dhjetorit 2006, me rastin e shqyrtimit të ankesës për pengim të posedimit. Gjykata Komunale vendosi masë të përkohshme me të cilën e obligoi R. R. të pezullojë veprimet e tij dhe të shembë murin.
19. Më 24 korrik 2007, Bujar Sahitaj dhe I. S., duke pretenduar statusin e ndërhyrësit në procedurë, propozuan përsëritjen e procedurës nga Gjykata

Komunale në Suharekë, duke u arsyetuar se Komuna nuk e ka pranuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu, dorëzoi edhe një deklaratë nga ish-Avokati Publik i Komunës së Suharekës, A. B., duke pohuar se, me rastin e përfundimit të punësimit të saj, rasti C. Nr. 83/89 ishte në vazhdim e sipër dhe se nënshkrimi i saj, që mbështeste aktgjykimin, ishte falsifikuar.

20. Gjykata Komunale në Suharekë, me Vendimin nr. 187/2007, e refuzoi propozimin për përsëritjen e procedurës, pasi ndërhyrësit nuk ishin paraqitur si palë në procedurat e mëparshme, prandaj nuk mund të gëzonin statusin e palës.
21. Në ankesën e parashtruesit kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale në Suharekë, Gjykata e Qarkut në Prizren nxori Aktvendimin Ac. Nr. 55/2008, e 6 tetorit 2008, me të cilin refuzoi ankesën si të pabazuar dhe rikonfirmoi vendimin e Gjykatës Komunale në Suharekë.
22. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut, duke pretenduar shkelje të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.
23. Gjykata Supreme e Kosovës, në pajtim me nenin 232 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, konsideroi që propozimi për revizion është i pabazuar. Gjykata Supreme theksoi se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale, C. Nr. 83/89, është përfundimtar për këtë rast, me të cilin konfirmohet pronësia për parcelën kadastrale nr. 1528. Gjithashtu, në pajtim me kreun IV të Ligjit të Procedurës Kontestimore, i cili rregullon çështjen e statusit të palës, refuzoi ankesën e ushtruar nga ndërhyrësit si të papranueshme.

Pohimet e parashtruesit të kërkesës

24. Paraqitësi i kërkesës pretendon se tre dëshmitarët kanë qenë të manipuluar dhe nën presion me rastin e dhënies së dëshmisë së tyre në Gjykatën Komunale në vitin 1989.
25. Më tej, parashtruesi konsideron si të gabueshëm vazhdimin e procedurës në Gjykatën Komunale në Suharekë, edhe pse pala paditëse kishte tërhequr kërkesën për njohjen e të drejtës pronësore.
26. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 421, paragrafi 2, në lidhje me nenin 423, paragrafi 3, të Ligjit të Procedurës Kontestimore.
27. Parashtruesi pretendon se i është shkelur e drejta në pronë, e garantuar me nenin 46, dhe e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

28. Gjykata Kushtetuese, për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka

plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

30. Prej dokumentacionit të dorëzuar nga parashtruesi, mund të konkludohet se kërkesa është parashtruar në Gjykatën Kushtetuese më 31 korrik 2012, përderisa vendimi i Gjykatës Supreme, i cili pretendohet nga parashtruesi se ia shkel të drejtat, ka fletëpranimin më 15 shkurt 2012. Si rrjedhojë, del se kërkesa është dorëzuar në Gjykatë Kushtetuese 5 muaj e 16 ditë pas pranimit të vendimit të Gjykatës Supreme.
31. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata gjen se kërkesa nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të parapara më nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, prandaj, në pajtim me nenin 49 të Ligjit, është e papranueshme dhe nuk mund të procedohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 20 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.2 dhe 56 të Rregullores së punës, më 27 maj 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T’UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani